



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2, Nr.18 Tiranë

Tel/Fax: 04 2268141; 2268142

Nr. 184 Prot.

Tiranë, më 13.03.2017

V E N D I M

Nr. 47, datë 13.03.2017

(Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit nr.105, datë 26.09.2016 dhe ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera nga Bashkia Belsh, gjatë procesit të emërimeve, të kryera prej datës 26.04.2016 e në vazhdim)

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil mbikëqyr, kryesisht ose me kërkesë të institucioneve, zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë, nxjerr vendime paralajmëruese në rast se konstaton parregullsi dhe përcakton detyra konkrete për rregullimin e situatës.

Për këtë arsye:

Në zbatim të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenet 11/1 dhe 14 , të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe nenit 34 e vijues të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmërues nr.105, datë 26.09.2016, të Komisionerit, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë realizimit të procedurave për rekrutim, transferim, ngritje në detyrë, në institucionin e Bashkisë Belsh, prej datës 26.04.2016 (*momenti i përfundimit të mbledhjes së dokumentacionit nga ana e Komisionerit mbi bazën e të cilave u analizua situata në shërbimin civil gjatë mbikëqyrjes*) e në vazhdim,

VENDOSA:

1. Fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit nr.105, datë 26.09.2016, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Belsh dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë".
2. Verifikimin e akteve të emërimit, të cilat kanë dalë në kundërshtim me kërkesat e ligjit, duke mosrespektuar procedurat e rekrutimit, në institucionin *Bashkia Belsh*, prej datës 26.04.2016 (*momenti i përfundimit të mbledhjes së dokumentacionit nga ana e Komisionerit mbi bazën e të cilave u analizua situata në shërbimin civil*) e në vazhdim,

sipas objektit dhe aneksit që përmban Programi i Verifikimit, i cili është pjesë e këtij vendimi.

3. Ngritjen e grupit të punës, me këtë përbërje:

| | |
|---------------------------|--|
| 1. Ilija Kukumi | Drejtor i Inspektimit dhe Hetimit Administrativ |
| 2. Gentiana Agushi | Inspektor, Drejtorja e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ |
| 3. Joni Marko | Specialist, Drejtorja e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë |

4. Ky proces do të fillojë me paraqitjen e grupit të punës në subjekt, në datën **28.03.2017** dhe do të përfundojë në datën **06.04.2017**.
5. Me përfundimin e verifikimit të akteve, grumbullimit të dokumentacionit dhe të dhënave në subjekt, grupi i punës, do të vijojë punën me përpunimin e të dhënave. Aktet e konstatimit, procesverbalet e mbajtura në subjekt, si dhe dokumentacioni i administruar, lidhur me zbatimin e vendimit të Komisionerit dhe verifikimin e ligjshmërisë së emërimeve të kryera nga institucioni, do t'i paraqiten për të vijuar procesin respektivisht Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Mbikëqyrjes dhe Inspektimit, brenda datës **29.03.2017**. Relacionet përkatëse duhet të përpilohen deri në datën **03.04.2017**. Më pas do t'i paraqiten për miratim Komisionerit, dhe më tej, do të hartohen vendimet për përmbylljen e proceseve, brenda **3** ditëve.
6. Vendimi përfundimtar dhe vendimi paralajmëruar i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për përmbylljen e procedimit administrativ (*verifikimit*) do t'i dërgohet subjektit të mbikëqyrur Bashkia Belsh.
7. Ngarkohet Drejtorja e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit dhe Drejtorja e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, që të marrin masat për realizimin e procesit, duke filluar me njoftimin e subjektit që do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes në përputhje me nenin 42, të Kodit të Procedurave Administrative dhe të akteve që janë pjesë e këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi Zogu I-rë, Godina 57, shk.2, Nr.18. Tiranë

Tel: 355 4 2268 141; Fax: 355 4 2268 142

Nr. 184/1 Prot.

Tiranë, 13.03.2017

M I R A T O H E T

Pranvera STRAKOSHA

KOMISIONER

PROGRAM VERIFIKIMI

(Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit nr.105, datë 26/09/2016, dhe ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera nga institucioni Bashkia Belsh, gjatë procesit të emërimeve, të kryera prej datës 26.04.2016 e në vazhdim).

- 1. Subjekti i mbikëqyrjes:** Bashkia Belsh
- 2. Objekti i verifikimit:** Zbatimi i Vendimit paralajmërues nr. 105, datë 26.09.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Belsh dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
- Verifikimi i akteve të emërimit, të cilat kanë dalë në kundërshtim me kërkesat e ligjit, duke mosrespektuar procedurat e rekrutimit, në institucionin e Bashkisë Belsh, prej datës 26.04.2016 (momenti i përfundimit të mbledhjes së dokumentacionit nga ana e Komisionerit mbi bazën e të cilave u analizua situata në shërbimin civil gjatë mbikëqyrjes) e në vazhdim.
- 3. Baza ligjore:** Neni 14, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe neni 34 e vijues i Rregullores “Mbi

procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

4. Periudha e verifikimit:

Fillon me datën e daljes së Vendimit paralajmërues të Komisionerit nr. 105, datë 26.09.2016 *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Belsh dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi dhe në datën e përfundimit të mbikëqyrjes në subjekt (26.04.2016), për rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin.

5. Afati i verifikimit:

Verifikimi do të fillojë në institucion në datën **28.03.2017** dhe do të përfundojë brenda datës **06.04.2017**.

6. Procedura që do të ndiqet:

Për parregullsitë e konstatuara do të mbahen aktet e konstatimit, procesverbal administrativ, të cilët do të nënshkruhen nga grupi i verifikimit dhe personat përgjegjës, si dhe do të merret kopja e dokumentacionit përkatës, vërtetuar nga sekretaria e institucionit.

7. Grupi i punës:

- | | |
|---------------------------|--|
| 1. Ilia Kukumi | Drejtor i Inspektimit dhe Hetimit Administrativ |
| 2. Gentiana Agushi | Inspektor, Drejtoria e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ |
| 3. Joni Marko | Specialist, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë |

8. Dokumentimi i rezultateve të verifikimit:

Në përfundim të procesit të verifikimit dhe mbikëqyrjes do të përgatiten relacionet përkatëse nga Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit, bazuar në aktet e konstatimit dhe procesverbalet e mbajtuara në subjektin e verifikuar si dhe do të administrohet dokumentacioni provues. Më pas do të hartohet vendimi përfundimtar i procedurave përmbyllëse të verifikimit të zbatimit të vendimit, i cili do të dërgohet institucionit (*n.q.s vendimi nuk është zbatuar, Komisioneri do të zbatojë kompetencën e parashikuar në nenin 15, pika 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar*) dhe vendimi paralajmërues në përfundim të verifikimit të ligjshmërisë së veprimeve administrative lidhur me emërimet e dala në kundërshtim me ligjin.

DREJTIMET E VERIFIKIMIT

I. Si janë zbatuar, detyrat e lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në Vendimin nr. 105, datë 26.09.2016 “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Belsh dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”, nga ana e Njesisë së Burimeve Njerëzore të institucionit të mbikëqyrur. Në këtë rast, verifikimi do të realizohet duke pasur parasysh nivelin e zbatimit të urdhërimeve në vendimin paralajmërues, si më poshtë, duke administruar kopje të akteve që materializojnë zbatimin e vendimit:

- “1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, në subjektin, Bashkia Belsh, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë:
2. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Belsh, si struktura përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore në këtë institucion, të rregullojë pasojat e paligjshmërisë në rastet kur punonjësit, nuk përmbushin kriterin e nivelit arsimor për të qenë nëpunës civilë dhe për të cilët nuk është kryer deklarimi i statusit të punësimit.

Nominalisht, këta punonjës janë:

1. *****, në pozicionin e punës “Inspektor Tatimesh”;
2. *****, në pozicionin e punës “Inspektor Kontrolli i Zhvillimit të Territorit”;
3. *****, në pozicionin e punës “Inspektor i Pastrimit Publik”;
4. *****, në pozicionin e punës “Inspektor i Punëve Publike”;
5. *****, në pozicionin e punës “Inspektor për Sportin”;
6. *****, në pozicionin e punës “Inspektor i Shtëpisë së Kulturës”;
7. *****, në pozicionin e punës “Punonjës Social”;
8. *****, në pozicionin e punës “Veteriner/Arkëtar”;
9. *****, në pozicionin e punës “P/Tatim-Taksash”;
10. *****, në pozicionin e punës “Inspektor Urbanistike/Agronom”;
11. *****, në pozicionin e punës “Inspektor Tatim-Taksa/Arkë”;
12. *****, në pozicionin e punës “Inspektor Mjedisi”;
13. *****, në pozicionin e punës “Administratë/Magazinë”;
14. *****, në pozicionin e punës “Agronom/ Veteriner”;
15. *****, në pozicionin e punës “Përgjegjës Tatim/Taksa”;
16. *****, në pozicionin e punës “Përgjegjës Personeli”;
17. *****, në pozicionin e punës “Veteriner/Arkëtar”;
18. *****, në pozicionin e punës “Administrator/Ndihmë Ekonomike” ;
19. *****, në pozicionin e punës “Agronom/Magaziner”.

Në këtë rast, njësia përgjegjëse duhet të rregullojë gjendjen e paligjshmërisë, duke kryer veprimet sipas këtij rendi:

- *Të ndryshojë aktin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës në lidhje me motivacionin dhe bazën ligjore, për arsye se këta punonjës nuk mund të përfitojnë nga neni 64 (“Dorëheqja”) i ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke evidentuar faktin se, ata nuk e përmbushin kriterin e nivelit arsimor për të qenë nëpunës civilë, në përputhje me kërkesat e ligjit të mësipërm.*
 - *Pozicionet e punës duhet të shpallen të lira, për t`u plotësuar më tej në përputhje me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në koherencë me strukturën aktuale dhe nevojat e Bashkisë Belsh.*
3. *Të kërkoj nga njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Belsh, të rregullojë gjendjen e paligjshmërisë lidhur me rastet e emërimeve të përkohëshme, të cilat janë kryer duke mos respektuar rregullat e pranimi në shërbimin civil, pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.*

Nominalisht, këta punonjës janë:

1. ******, emëruar me urdhrin nr. 156, datë 01.04.2016, në pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm”, pranë Bashkisë Belsh.*
2. ******, emëruar me urdhrin nr. 16, datë 10.08.2015, në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Financës, Tatim Taksa, Ndihma Ekonomike”, pranë Bashkisë Belsh.*
3. ******, emëruar me urdhrin nr. 144, datë 01.04.2016, në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Financës”, pranë Bashkisë Belsh.*
4. ******, emëruar me urdhrin nr. 125, datë 01.10.2015, në pozicionin “Specialiste Finance”, pranë Bashkisë Belsh.*
5. ******, emëruar me urdhrin nr. 97, datë 23.09.2015, në pozicionin “Përgjegjës i Ndihmës Ekonomike”, pranë Bashkisë Belsh.*
6. ******, emëruar me urdhrin nr. 65, datë 02.03.2016, në pozicionin “Inspektor Social”, pranë Bashkisë Belsh.*
7. ******, emëruar me urdhrin nr. 71, datë 08.03.2016, në pozicionin “Inspektor Social”, pranë Bashkisë Belsh.*
8. ******, emëruar me urdhrin nr. 165, datë 11.11.2015, në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit”, pranë Bashkisë Belsh.*
9. ******, emëruar me urdhrin nr. 61, datë 02.03.2016, në pozicionin “Përgjegjës Sektori në Sektorin e Zhvillimit të Lejeve”, pranë Bashkisë Belsh.*
10. ******, emëruar me urdhrin nr. 155, datë 05.11.2015, në pozicionin “Specialist Planifikimi dhe Zhvillim Territori”, pranë Bashkisë Belsh.*
11. ******, emëruar me urdhrin nr. 141, datë 01.04.2016, në pozicionin “Jurist në Sektorin e Projektiveve”, pranë Bashkisë Belsh.*
12. ******, emëruar me urdhrin nr. 62, datë 02.03.2016, në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Menaxhimeve Bujqësore, Veterinare”, pranë Bashkisë Belsh.*
13. ******, emëruar me urdhrin nr. 134, datë 05.11.2015, në pozicionin “Përgjegjës Sektori në Sektorin e Shërbimeve Bujqësore dhe Veterinare”, pranë Bashkisë Belsh.*
14. ******, emëruar me urdhrin nr. 66, datë 03.03.2016, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Shërbimeve Bujqësore dhe Veterinare”, pranë Bashkisë Belsh.*
15. ******, emëruar me urdhrin nr. 38, datë 25.02.2016, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Shërbimeve Bujqësore dhe Veterinare”, pranë Bashkisë Belsh.*
16. ******, emëruar me urdhrin nr. 143, datë 01.04.2016, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Shërbimeve Bujqësore dhe Veterinare”, pranë Bashkisë Belsh.*

17. *****, emëruar me urdhrin nr. 143, datë 01.04.2016, në pozicionin “Inspektor Pyjesh në Sektorin e Shërbimeve Bujqësore dhe Veterinare”, pranë Bashkisë Belsh.
18. *****, emëruar me urdhrin nr. 142, datë 01.04.2016, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Shërbimeve Bujqësore dhe Veterinare”, pranë Bashkisë Belsh.
19. *****, emëruar me urdhrin nr. 115, datë 17.03.2016, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Kadastrës, Topografisë dhe Regjistrimit”, pranë Bashkisë Belsh.
20. *****, emëruar me urdhrin nr. 114, datë 17.03.2016, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Kadastrës, Topografisë dhe Regjistrimit”, pranë Bashkisë Belsh.
21. *****, emëruar me urdhrin nr. 134, datë 25.03.2016, në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë Juridike”, pranë Bashkisë Belsh.
22. *****, emëruar me urdhrin nr. 60, datë 02.03.2016, në pozicionin “Përgjegjës Sektori në Sektorin Juridik”, pranë Bashkisë Belsh.
23. *****, emëruar me urdhrin nr. 54, datë 01.03.2016, në pozicionin “Përgjegjës Sektori në Sektorin e Prokurimeve”, pranë Bashkisë Belsh.
24. *****, emëruar me urdhrin nr. 127, datë 18.03.2016, në pozicionin “Jurist në Sektorin e Prokurimeve”, pranë Bashkisë Belsh.
25. *****, emëruar me urdhrin nr. 31, datë 25.02.2016, në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore”, pranë Bashkisë Belsh.
26. *****, emëruar me urdhrin nr. 15, datë 10.08.2015, në pozicionin “Përgjegjës Sektori në Sektorin e Burimeve Njerëzore”, pranë Bashkisë Belsh.
27. *****, emëruar me urdhrin nr.118, datë 01.10.2015, në pozicionin “Punonjës i IT”, pranë Bashkisë Belsh.
28. *****, emëruar me urdhrin nr. 90, datë 18.09.2015, në pozicionin “Punonjës i Arshivës dhe Protokollit”, pranë Bashkisë Belsh.
29. *****, emëruar me urdhrin nr. 148, datë 01.04.2016, në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore”, pranë Bashkisë Belsh.
30. *****, emëruar me urdhrin nr. 147, datë 01.04.2016, në pozicionin “Përgjegjës Sektori në Sektorin e të Ardhurave Vendore”, pranë Bashkisë Belsh.
31. *****, emëruar me urdhrin nr. 137, datë 30.03.2016, në pozicionin “Inspektor Tatimesh në Sektorin e të Ardhurave Vendore”, pranë Bashkisë Belsh.
32. *****, emëruar me urdhrin nr. 52, datë 01.03.2016, në pozicionin “Inspektor Tatimesh në Sektorin e të Ardhurave Vendore”, pranë Bashkisë Belsh.
33. *****, emëruar me urdhrin nr. 146, datë 01.04.2016, në pozicionin “Përgjegjëse Sektori në Sektorin e Transportit dhe Menaxhimit të Tregut”, pranë Bashkisë Belsh.
34. *****, emëruar me urdhrin nr. 63, datë 02.03.2016, në pozicionin “Inspektor Tatimesh në Sektorin e Transportit dhe Menaxhimit të Tregut”, pranë Bashkisë Belsh.
35. *****, emëruar me urdhrin nr. 145, datë 01.04.2016, në pozicionin “Inspektor Tatimesh në Sektorin e Transportit dhe Menaxhimit të Tregut”, pranë Bashkisë Belsh.
36. *****, emëruar me urdhrin nr. 11, datë 10.08.2015, në pozicionin “Përgjegjës Sektori në Sektorin e Mirëmbajtjes së Rrugëve, Objekteve”, pranë Bashkisë Belsh.
37. *****, emëruar me urdhrin nr. 10, datë 25.01.2015, në pozicionin “Përgjegjës Sektori në Sektorin e Arsimit, Kulturës dhe Sportit”, pranë Bashkisë Belsh.
38. *****, emëruar me urdhrin nr. 119, datë 01.10.2015, në pozicionin “Inspektor i Arsimit në Sektorin e Arsimit, Kulturës dhe Sportit”, pranë Bashkisë Belsh.
39. *****, emëruar me urdhrin nr. 151, datë 01.04.2016, në pozicionin “Inspektore Arsimi në Sektorin e Arsimit, Kulturës dhe Sportit”, pranë Bashkisë Belsh.
40. *****, emëruar me urdhrin nr. 140, datë 01.04.2016, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Shërbimeve Bujqësore dhe Veterinare”, pranë Bashkisë Belsh.

41. ******, emëruar me urdhrin nr. 171, datë 18.04.2016, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Shërbimeve Bujqësore dhe Veterinare”, pranë Bashkisë Belsh.*

Për këto raste, njësia përgjegjëse duhet të rregullojë situatën e paligjshmërisë, duke kryer veprimet sipas këtij rendi:

- *Të revokojë aktet përkatëse të emërimit dhe të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit të punonjësve me institucionin.*
- *Pozicionet e punës duhet të shpallen të lira, për t'u plotësuar më tej në përputhje me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në koherencë me strukturën aktuale dhe nevojat e Bashkisë Belsh.*

Njësia përgjegjëse, duhet të veprojë në koherencë me situatën që do të rezultojë pas përfundimit të procesit të deklarimit të statusit të punësimit. Për punonjësit që do të përfitojnë statusin e nëpunësit civil duhet të bëhet emërimi, pa konkurim, nëse i plotësojnë kërkesat për një nga këto pozicione.

4. *Të kërkoj nga njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Belsh, lidhur me punonjësit e punësuar në pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, pranë ish-Komunave (sot Njësitë Administrative) Grekan, Rrasë, Fierzë dhe Kajan, të rregullojë gjendjen e paligjshmërisë në lidhje me deklarimin e statusit të punësimit, duke kryer veprimet sipas këtij rendi:*

- *Të plotësojë dosjet individuale me të gjitha të dhënat sipas kërkesave të ligjit, me qëllim që të mundësohet procesi i verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe kërkesave të posaçme për vendin e punës.*
- *Pas përfundimit të verifikimit, të deklarojë ose të refuzojë statusin e punësimit për secilin prej tyre.*

5. *Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Belsh, në kushtet e riorganizimit të institucionit, të fillojë menjëherë punën për hartimin dhe miratimin e përshkrimeve të punës, për pozicionet e shërbimit civil, në përputhje me legjislacionin specifik të fushës dhe formatin standard të miratuar, ashtu siç përcaktohet në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, ndryshuar me VKM nr. 262, datë 25.03.2015 dhe lidhjes nr. 4, bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe në Udhëzimin nr. 2, datë 07.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”.*

6. *Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Belsh, të hartojë planin vjetor të pranimeve të reja në shërbimin civil, sipas kërkesave të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”.*

7. *Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Belsh, të marrë masa të menjëhershme për të kryer procesin e vlerësimeve të rezultateve të punës të punonjësve sipas legjislacionit të shërbimit civil, në zbatim të nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe*

Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”.

8. *Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 60 ditë nga marrja dijani për këtë vendim. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e materializuara në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.*

Në rast të konstatimit të moszbatimit të pjesshëm apo të plotë të vendimit të Komisionerit, do të mbahet procesverbal konstatimi, i cili do të nënshkruhet nga grupi i punës dhe personi përgjegjës.

- II.** Verifikimi i ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera nga ky institucion, lidhur me emërimet të cilat kanë dalë në kundërshtim me kërkesat e ligjit, duke mos u respektuar procedurat e rekrutimit, duke filluar nga data 26.04.2016 (*momenti i përfundimit të mbledhjes së dokumentacionit nga ana e Komisionerit mbi bazën e të cilave u analizua situata në shërbimin civil*) e në vazhdim. Në rast të konstatimit të veprimeve të parregullta që kanë të bëjnë me këtë institut të ligjit, do të administrohen kopje të akteve, si dhe do të procedohet me procesverbal konstatimi, i cili do të nënshkruhet nga grupi i punës dhe personi përgjegjës.

Aneks i programit: Aktet administrative që duhet të vihen në dispozicion të grupit të verifikimit.

Në vijim të programit të verifikimit, më poshtë po rendisim aktet që duhet të vihen në dispozicion të grupit të verifikimit për të përfunduar këtë proces.

1. Provat shpresore të cilat vërtetojnë zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me vendimin paralajmërues.
2. Struktura organizative dhe analitike e institucionit që ka qenë në fuqi në momentin e mbikëqyrjes dhe ajo aktuale.
3. Listëpagesat dhe listëprezencat e institucionit, duke filluar nga momenti e mbikëqyrjes së mëparshme deri tek ato aktuale.
4. Aktet administrative të cilat materializojnë emërimet në kundërshtim me ligjin, (aktet e emërimit/ kontratat e përkohshme të punës).
5. Dosjet personale të nëpunësve të emëruar pas verifikimit të kryer në kuadër të mbikëqyrjes.

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM
I INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Arbana BASHA

**DREJTORI I ÇËSHTJEVE JURIDIKE
DHE I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË**

Enkelejda HEBIBASI